

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 14.07.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi kërkesën e mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Hristijan Spirovski nga S., nxori këtë:

KONKLUZION

Kërkesa për miratimin e mendimit juridik parimor Su-03 nr.231/2022, të parashtruar nga avokati Hristijan Spirovski nga S., NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06 ... nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 14.07.2022, diskutoi mbi kërkesën për miratimin e mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Hristijan Spirovski nga S., Su-03 nr.232/2022, për çështjen juridike: A mundet që në procedurë për lëshimin e urdhër pagesës të realizohet e drejta e regresit ose ajo mund të realizohet ekskluzivisht në procedurën për padinë e rregullt.

Në kërkesën e parashtruar, parashtruesi e ka nënshtuar gjendjen e lëndës së Gjykatës Themelore Ohër MALVPL1 – P-6/18, e filluar me kundërshtimin e të paditurit, autorizues i të cilit është parashtruesi i kësaj kërkesë kundër aktvendimit për lëshimin e urdhër pagesës për noter NPN.nr.147/18 të datës 11.07.2018, të miratuar në bazë të dokumentit autentik – kartelës analitike të regreseve. Në fakt, gjykata e shkallës së parë ka miratuar aktgjykim me të cilin e miraton pjesërisht kundërshtimin e të paditurit dhe aktvendimin për lëshimin e urdhër pagesës për noter nën numrin dhe datën e theksuar e ka lënë në fuqi, në një pjesë aktvendimi është abroguar dhe në atë pjesë kërkesa e padisë është refuzuar si e pabazë, aktgjykimi i theksuar është refuzuar si i pabazë, aktgjykimi i theksuar është konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Manastir TSZH-1405/20 të datës 01.02.2021.

Sipas parashtruesit, sipas rregullave pozitive dhe praktikës së deritanishme gjyqësore, regresi si e drejtë sipas nenit 16 të Ligjit për sigurimin e obligueshëm në komunikacion, realizohet në procedurë të veçantë për arsye se ajo është kompensim i dëmit që në rrugë të subrogimit e ndryshon identitetin subjektiv të kërkuarit për atë të drejtë.

Në kontestin konkret gjykata e shkallës së parë dhe të dytë gabimisht duke u nisur nga dispozita e theksuar ligjore kanë vlerësuar se janë plotësuar kushtet respektivisht se e theksuara mund të diskutohet dhe për të njëjtën të vendoset në procedurën për lëshimin e urdhër pagesës për noter, gjë kjo që sipas parashtruesit është e gabuar. Së pari për arsye se, vetëm me padi të rregullt paditësi e dëshmon para se gjithash legjitimitetin e tij aktiv për të parashtruar padi për

regres, respektivisht se janë plotësuar kushtet e nenit 16 të Ligjit për sigurimin e obligueshëm në komunikacion dhe se në rrugë të subrogimit ka marrë të drejtën të kërkojë pagimin e dëmit të paguar. Pasi që të miratohet e theksuara deri atëherë paditësi mund të kërkojë kondemnizim – detyrimi i të paditurit me shumën që paditësi ia ka paguar personit të tretë si dëm, por jo edhe si në rastin konkret të ngritur me propozim për miratimin e aktvendimit për urdhër pagesë për noter në bazë të dokumentit autentik – kartelës analitike. E theksuara pa marrë parasysh faktin që kartelat analitike i përpilojnë persona të autorizuar te paditësi në bazë të ndonjë farë baze juridike, si dhe pa marrë parasysh që në evidencën e paditësit në konto regresin është evidentuar kërkesë që nuk ka qenë e mbështetur me dokument përkatës juridik.

Për shkak të së theksuarës, parashtruesi propozon që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të japë përgjigje për çështjen e parashtruar juridike me qëllim që të ofrojë siguri juridike. Në atë drejtim, sepse qëllimi i iniciativës së parashtruar nuk ka qenë të bëhet revidimi i vendimeve të cituara të miratuara gjyqësore, por që të sqarohet se pse parashtruesi konsideron se ekziston nevoja për miratimin e mendimit juridik parimor për veprimin e lëndëve të tilla në të ardhmen.

Duke u nisur nga e theksuara, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konsideron se nuk nevojitet miratimi i mendimit juridik parimor, ngase në bashkëngjitje të kërkesës së parashtruar nuk është dorëzuar praktikë e ndryshme gjyqësore, respektivisht vendime tjera, nga të cilat rezulton zbatim i ndryshëm dhe jo konsekuencë të procedurës për lëshimin e urdhër pagesës, vetëm është dorëzuar vendim në kontestin konkret ku parashtrues është autorizuesi i të paditurit në procedurën.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u udhëhequr nga e sipër konstatuara, arriti në konkluzion se nuk janë plotësuar kushtet për miratimin e mendimit juridik parimor mbi çështjen me kuptim për sigurimin e barazisë me zbatimin e ligjeve nga gjykatat, në kuptim të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat dhe për çështjen juridike të parashtruar me kërkesën e parashtruar, në mënyrë që vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 14.07.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi kërkesën e mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Hristijan Spirovski nga S., nxori këtë:

KONKLUZION

Kërkesa për miratimin e mendimit juridik parimor Su-03 nr.232/2022, të parashtruar nga avokati Hristijan Spirovski nga S., NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06 ... nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 14.07.2022, diskutoi mbi kërkesën për miratimin e mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Hristijan Spirovski nga S., Su-03 nr.232/2022, për çështjen juridike: Vallë sipas nenit 33, nenit 101 dhe nenit 104 të Ligjit për marrëveshje për transport në komunikacionin rrugor, transportuesi mund të kërkojë t'ia paguajë taksën e kontraktuar për transportin në procedurë gjyqësore, nga organizatori i transportit që e ka lëshuar për shkarkim ose si obligim solidar do ta kërkojë nga dërguesi ose nga pranuesi ose nga të tre subjektet.

Në propozimin e parashtruar theksohet se në kontestin konkret të parashtruar me propozim për lëshimin e urdhër pagesës për noter është miratuar aktvendim për lëshimin e urdhër pagesës për noter nga noteri kompetent që me rastin e kundërshtimit të parashtruar nga i padituri, është refuzuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ohër PL1 – TS-8/19 të datës 01.10.2019, e pastaj aktgjykimi i theksuar është konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Manastir TSZH-229/20 të datës 01.02.2021. Në procedurën e theksuar, avokati i theksuar është autorizuesi i të paditurit në atë kontest.

Sipas parashtruesit gjatë vlerësimit të së drejtës materiale prioritet duhet t'i jepet nenit 33 paragrafi (2) dhe (3) të Ligjit për marrëveshje për transport në komunikacionin rrugor, në atë drejtim theksohet përmbajtja e kësaj dispozite, si dhe dispozita e nenit 104 paragrafi (5) dhe (6) nga i njëjti ligj.

Sipas mendimit të parashtruesit nga dispozitat e theksuara ligjore rezulton se organizatori i transportit nuk ka mundur të jetë i legjitimuar pasiv në procedurën për kompensimin e shpenzimeve për transport – bartës, ngase obligimi ka kaluar te pranuesi i mallit sipas nenit 33 paragrafi (2) nga ligji i theksuar. Njëkohësisht, se sipas paragrafit (3) të nenit 33, përcaktohet se në mënyrë ekskluzive organizatori, në kontestin konkret i padituri, që të mund të përfshihet me padinë në qoftë se pas mosplotësimit të obligimeve nga ana e pranuesit të mallit sipas nenit 33

paragrafi (2) të Ligjit për marrëveshje për transport në komunikacionin rrugor edhe atë në mënyrë solidare me dërguesin dhe pranuesin e mallit. Sipas parashtruesit, i padituri si organizator do të mund të paraqitet si i paditur së bashku me dërguesin dhe pranuesin e mallit si të vetmit bashkëkontestimorë, por në asnjë rast procedura nuk mund të udhëhiqet vetëm kundër organizatorit të transportit, që në kontestin konkret ka qenë i vetmi i paditur. Që të ekzistojë përgjegjësia solidare konsideron se të gjithë personat duhet të përfshihen si të paditur në procedurën, në kundërshtim se nuk ka legjitimacion pasiv të tërësishëm nga ana e të paditurit.

Për shkak të së theksuarës, në propozimin kërkohet që të përgjigjet për çështjen e sipër theksuar, duke bashkëngjitur aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ohër PL1-TS-8/19 të datës 01.10.2019 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Manastir TSZH-229/20 të datës 01.02.2021.

Duke u nisur nga e theksuara, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konsideron se nuk nevojitet që të miratohet mendim juridik parimor, ngase në bashkëngjitje të kërkesës së parashtruar nuk është dorëzuar praktikë e ndryshme gjyqësore, përkatësisht vendime tjera nga të cilat do të rezultonte zbatim i ndryshëm dhe papërshtatshmëri në zbatimin e Ligjit për marrëveshje për transport në komunikacionin rrugor, vetëm se është dorëzuar vendimi i kontestit konkret, ku parashtruesi është autorizues i të paditurit në procedurën.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u udhëhequr nga e sipër përcaktuara, erdhi në konkluzion se nuk plotësohen kushtet për miratimin e mendimit juridik parimor për çështje me kuptim për sigurimin e barazisë së ligjeve nga ana e gjykatave, në kuptim të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, ndërsa për çështjen e parashtruar juridike me kërkesën e parashtruar, në mënyrë që vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut

Seanca e përgjithshme

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 14.07.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), nenit 48 dhe 49 paragrafi (3) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi iniciativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Bllagoja Pandovski nga S., nxori këtë:

KONKLUZION

Iniciativa për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Bllagoja Pandovski nga S., NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06 ... nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 14.07.2022, diskutoi mbi iniciativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Bllagoja Pandovski nga S., kur një person do të shpallet fajtor dhe dënohet për kundërvajtje dhe i shqiptohet në gjobë për procedurë për kundërvajtje, për të njëjtin person, sipas qëndrimit të Gjykatës Themelore Penale Shkup dhe Gjykatës së Apelit Shkup nuk mund të udhëhiqet procedurë penale, si e mëvonshme, me sqarim se veç më është çështje e vendosur.

Parashtruesi i iniciativës, si autorizues i të dëmtuarit, në procedurë penale tanimë aktuale dhe vijuese e ngritur me padi private penale për vepër penale – "Lëndimi trupor" nga neni 130 të Kodit penal, ka pranuar një parashtrësë me njoftim se bëhet fjalë për një çështje veç më të vendosur. Në fakt, i akuzuari me kundërvajtje ka qenë i shpallur fajtor për kundërvajtje në nenin 11 të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike dhe i është caktuar gjobë në shumë prej 250 euro, në kundërvlerë me denarë, të cilën e ka paguar.

Parashtruesi i iniciativës tregon se praktikë të pabarabartë gjyqësore në vendosjen e Gjykatës Themelore Penale Shkup dhe të Gjykatës së Apelit Shkup lidhur me zbatimin e parimit *Ne bis in idem*, ku në bashkëngjitje të iniciativës janë dorëzuar aktgjykimet të Gjykatës Themelore Penale Shkup K.nr.2091/18 të datës 10.10.2019 dhe të Gjykatës së Apelit KZH-993/19 të datës 25.02.2020, me të cilën është konfirmuar aktgjykimi i shkallës së parë; aktvendimi i Gjykatës Themelore Penale Shkup K.nr.974/19 të datës 12.04.2021, me të cilin është ndërprerë procedura penale kundër të akuzuarit, ngase para fillimit të seancës kryesore përfaqësuesi i aktakuzës është tërhequr nga aktakuza, sipas nenit 352 të LPP dhe ekstrakt nga Buletini nr.7 të Gjykatës së Apelit Shtip për lëndën e kësaj gjykate KZH.nr.134/12 të datës 20.03.2012.

Në mbështetjen e të dhënave në iniciativën e parashtruar, parashtruesi thërritet në kriteret *Engel* të miratuara nga Gjykata për të Drejtat e Njeriut dhe lënda e *Maresti v. Kroacia*.

Po ashtu, në iniciativën është theksuar se nuk është e qartë se si gjykatat presin që i akuzuari të realizojë të drejtën e tij për kompensim dëmi nga vepra penale, pasi që është më tepër se e sigurt se vendimi i miratuar në procedurë për kundërvajtje nga ana e Organit drejtues

– MPB nuk mund të shërbejë si vendim gjyqësor dhe bazë për mbrojtjen e kërkesës pronësoro – juridike në procedurë civile.

Në fund, në iniciativën e parashtruesit është theksuar se vepra penale dhe kundërvajtja kanë objekt të ndryshëm të mbrojtjes dhe sipas drejtimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe *Engel* kriteret kërkon që Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme sipas nenit 37 të Ligjit për gjykatat, të miratohet mendim juridik parimor në situatat kur kryerësi i kundërvajtjes sipas ligjit duhet edhe penalisht të sanksionohet, që të sigurohet praktikë e barabartë gjyqësore të gjykatave më të ulëta, zbatimi i barabartë i ligjeve, në mënyrë që do të mundësohet realizimi i principit për sundimin e ligjit dhe sigurisë juridike të qytetarëve.

Parimi *Ne bis in idem* përfshihet në nenin 4 Protokollin numër 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Ky nen përfshin 3 garanci të veçanta – asnjë nuk mund të përsëritet:

- 1.I ekspozuar ndaj ndjekjes;
- 2.I gjykuar, as,
- 3.I dënuar për të njëjtën vepër;

Për ti dhënë përgjigje pyetjes se nëse personi “është i liruar plotfuqishëm ose i dënuar në pajtim me ligjin në procedurën penale të shtetit” është e nevojshme që në radhë të parë t’i përgjigjet pyetjes:

I. Nëse procedurat për të cilat bëhet fjalë paraqesin “materie penale”? Për atë qëllim zbatohen të ashtuquajturat kritere Engel:

- 1.Klasifikimi i veprës në drejtësinë vendore;
- 2.Natyra e sjelljes së kundërligjshme dhe
- 3.Lloji dhe rëndësia e dënimit të kanosur.

II. A janë të njëjta “idem” veprat për të cilat ndërmerret ndjekja?

III. A ekziston “vendim përfundimtar” në procedurën e parë?

IV. A ekziston veprim i dyfishtë “bis”?

Në lëndën *Maresti v. Kroacia*, gjykata për kundërvajtje në përshkrimin faktik të kundërvajtjes “prishjen e rendit dhe qetësisë publike” e ka vënë edhe faktin se parashtruesi, personin tjetër e ka goditur me duar dhe me këmbë, edhe pse ato fakte i tejkalojnë suazat e përshkrimit ligjor të kundërvajtjes për të cilën bëhet fjalë. Për shkak të zgjerimit të tillë të përshkrimit faktik, vendimi dënues përfshin edhe dënimin e kësaj strukture faktike, dhe ngritja e procedurës penale për shkak të shkaktimit të lëndimeve të rënda trupore ishte në kundërshtim me parimin *Ne bis in idem*.

Në aktgjykimin e Gjykatës Themelore Penale Shkup K.nr.2091/18 të datës 10.10.2019, e konfirmuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Shkup KZH.nr.993/19 të datës 25.02.2020, në të cilën thërritet parashtruesi i iniciativës në veprimet e kryera të përshkruara në aktgjykimin për kundërvajtje të Gjykatës Themelore Shkup I Shkup PRK-J.nr.320/17 të datës 28.01.2019 dhe veprimin e kryerjes në aktakuzën e parashtruar dhe kumtimin e aktgjykimit kanë të bëjnë për të njëjtën ngjarje të ndodhur në të njëjtën ditë, në mënyrë që nuk mund të udhëhiqen dy procedura për të njëjtën ngjarje. Në këto aktgjykime, gjykatat më të ulëta me të drejtë janë thërritur në nenin 4 nga Protokollin numër 7 ndaj Konventës dhe nenit 7 të LPP, se askush nuk mund të gjykohe

përsëri ose të dënohet për vepër, për të cilën veç më është dënuar dhe për atë është miratuar vendim i plotfuqishëm gjyqësor. Në këtë rast, i akuzuari veç më ka qenë i shpallur fajtor për kundërvajtje sipas nenit 12 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike dhe është dënuar me sanksion gjobë në shumë prej 600 euro, në kundërvlerë me denarë.

Në aktvendimin e Gjykatës Themelore Penale Shkup K.nr.974/19 të datës 12.04.2021, është ndërprerë procedura penale kundër të akuzuarit, ngase para fillimit të seancës kryesore përfaqësuesi i aktakuzës ka heq dorë nga aktakuza kundër të akuzuarit sipas nenit 352 të LPP. Në këtë lëndë, kundër të akuzuarit veç më ka qenë formuar lëndë për kundërvajtje të bërë sipas nenit 11 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike, në të cilën procedurë i akuzuari është dënuar me gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë, dhe në krahasim me dispozitivin e propozimit të aktit akuzues të parashtruar gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se bëhet fjalë për të njëjtën ngjarje të ndodhur në të njëjtën kohë, në mënyrë që Prokurori publik sipas nenit 352 të LPP ka heq dorë nga akti akuzues, i parashtruar për vepër penale "Dhuna" nga neni 386 paragrafi (3) në lidhje me paragrafin (1) të Kodit penal.

Lidhur me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Shtip KZH.nr.134/12 të datës 20.03.2012, kur gjykata duke vepruar për ankesën e Prokurorit Themelor Publik të njëjtin e ka aprovuar në tërësi dhe ka theksuar se bëhet fjalë për ekzistimin e njëkohshëm të rregullave ligjore, me të cilat sipas Kodit penal është paraparë përgjegjësi penale, ndërsa sipas Ligjit për lëndë të para minerale përgjegjësia për kundërvajtje e kryerësit për veprimet e kundërligjshme gjatë eksploatimit të lëndëve të para minerale pa koncesion, respektivisht pa leje. Në fakt, gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar se vepra për të cilën akuzohet i akuzuari nuk është vepër penale sipas ligjit dhe për atë shkak e ka liruar nga akuza, ngase sipas nenit 75 paragrafi (1) pika 8 dhe paragrafi (5) të Ligjit për lëndë të para minerale, i njëjti veprim është sanksionuar si kundërvajtje, në këtë mënyrë duke u thërritur në nenin 3 paragrafi (2) të Kodit penal se sanksionet për kundërvajtje janë më të buta sesa për veprat penale, sipas të theksuarës gjatë ekzistimit të përgjegjësive për kundërvajtje për të njëjtën vepër është shënuar pa nevojë përgjegjësi penale. Në nenin 225-a paragrafi (1) të Kodit penal, është përcaktuar se penalisht është përgjegjës ai i cili bën eksploatimin e lëndëve të para minerale të përcaktuara me ligj pa koncesion ose leje. Në rastin konkret, i akuzuari është akuzuar se në kundërshtim të dispozitave nga Ligji për lëndë të para minerale ka bërë eksploatimin e lëndëve të para minerale kur në vendin kritik nga shtrati i lumit ka kryer nxjerrjen e rërës ndërtimore dhe zhavorrit, të cilat i ka ngarkuar në një rimorkio të lehtë të tërhequr me traktorin e tij, edhe pse për atë nga organi kompetent nuk ka marrë koncesion dhe leje për eksploatimin e këtij lloji të lëndëve të para minerale. Nga këtu, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për zbatimin e ligjit më të butë sipas nenit 3 paragrafi (2) të Kodit penal, ngase nuk bëhet fjalë për ndryshimin e ligjit ekzistues, por bëhet fjalë për ekzistimin e njëkohshëm të rregullave ligjore, me të cilat sipas Kodit penal është paraparë përgjegjësi penale, ndërsa sipas Ligjit për lëndë të para minerale përgjegjësi për kundërvajtje për kryerësin për sjelljen e kundërligjshme – gjatë kryerjes së eksploatimit të lëndëve të para minerale pa koncesion, respektivisht pa leje. Nga këtu, gjykata e shkallës së dytë është thërritur në dispozitivin e nenit 47 paragrafi (2) të Kodit penal, sipas të cilës në dënimin e shqiptuar për vepër penale karakteristika e të cilës e përfshin edhe karakteristikën për kundërvajtje, dënimi i paguar për kundërvajtjen e kryer llogaritet në dënimin për veprën penale, ku sipas nenit 119 paragrafi (1) pika 7 të Ligjit për kundërvajtje, në qoftë se në procedurën penale i akuzuari plotfuqishëm është shpallur fajtor për vepër penale që e përfshin edhe karakteristikën e kundërvajtjes, atëherë ai me aktgjykim për kundërvajtje lirohet nga përgjegjësia. Nga këtu, kur veç më për këtë vepër penale kundër të akuzuarit është ngritur akuzë atëherë gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se gjykata ka qenë e obliguar për të njëjtën të prononcohet dhe të konstatojë nëse ai e ka kryer veprën penale apo jo, e jo të konstatojë se bëhet fjalë për kundërvajtje e jo për vepër penale. Në rast të identitetit ndërmjet kundërvajtjes dhe veprës penale përkufizimi bëhet në bazë të

intensitetit të rrezikut të përgjithshëm të veprimeve, ku veprimi me rrezik më të madh shoqëror (rrezik nga intensiteti më i madh) është vepër penale.

Në këtë rast, lidhur me zbatimin e parimit *Ne bis in idem*, në Gjykatën Supreme të RMV është vendosur për lëndët VKZH2.nr.8/17 dhe KVP2.nr.47/19, në mënyrë që edhe në të dyja lëndët është konstatuar se nuk ka shmangie nga ky parim.

Megjithatë, për dallim nga këto lëndë, në lëndën KZZ.nr.4/22, që është formuar me kërkesë të parashtruar për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut KOZ.nr.180/20 të datës 04.11.2021 kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Penale Shkup K.nr.1517/19 të datës 22.10.2019 dhe kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit Shkup KZH.nr.65/20 të datës 04.03.2020, Gjykata Supreme konstaton veprim në kundërshtim të këtij parimi.

Në fakt, në këtë lëndë, gjykata e shkallës së parë me aktvendim e ka hedhur poshtë propozimin e aktit akuzues për vepër penale “Lëndimi i rëndë trupor” nga neni 131 paragrafi (1) të Kodit penal, sipas nenit 474 në lidhje me nenin 337 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për procedurë penale, si çështje e vendosur që e përjashton ndjekjen penale, se kundër të akuzuarit për të njëjtën ngjarje veç më ka qenë udhëhequr procedurë për kundërvajtje sipas nenit 12 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike, që është konfirmuar nga gjykata e shkallës së dytë dhe që plotfuqishëm ka përfunduar me sanksion të shqiptuar për kundërvajtje Paralajmërim.

Në këtë rast, në procedurën për kundërvajtje sanksionohet prishja e rendit dhe qetësisë me: “sulmim fizik të një personi tjetër në vend publik, që rezulton me lëndime në lloj të skuqjes dhe ënjtjes së fytyrës dhe kokës së të dëmtuarit”.

Te procedura penale që është ndërprerë, dhe që është dashur të udhëhiqet për propozimin e Aktit akuzues për vepër penale “Lëndim i rëndë trupor” nga neni 131 paragrafi (1) të Kodit penal, për të njëjtën ngjarje, veprime kundërligjore janë: “shkaktimi i thyerjes së nofullës së poshtme në pjesën e qafës nga ana e majtë”, që është plotësim i esencës ligjore të veprës penale “Lëndim i rëndë trupor”, ku objekt mbrojtjeje është integriteti trupor i të dëmtuarit.

Nga këtu, procedura penale do të sanksiononte aspekt të ndryshëm të sjelljes kundërligjore të akuzuarit, për të njëjtën ngjarje, që nuk është përfshirë në procedurën për kundërvajtje, as që ka mundur të jetë, ngase lëndimi i rëndë i shkaktuar trupor i të dëmtuarit nuk është element i esencës ligjore për kundërvajtje, ku në atë mënyrë do të realizohej përgjigje e kompletuar e sjelljes së përgjithshme të papranuar për dënimin gjithëpërfshirës në tërësi të akuzuarit.

Në këtë lëndë, procedura përfundimtare/rrijdhëse penale ka rezultuar me hedhjen poshtë të propozimit të aktit akuzues, ku i akuzuari nuk është sanksionuar për shkaktimin e thyerjes së nofullës së poshtme së të dëmtuarit (lëndim i rëndë trupor), ashtu që sanksionimi për kundërvajtjen e të akuzuarit nuk mund të llogaritet si çështje e vendosur dhe për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, ngase ajo si pasojë e shkaktuar nga veprimi i kundërligjshëm i të akuzuarit nuk janë element i përshkrimit ligjor të kundërvajtjes, por të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor” nga neni 131 paragrafi (1) të Kodit penal, për atë edhe është parashtruar propozim për aktin akuzues pas plotfuqishmërisë së vendimit për kundërvajtje, që në mënyrë të parregullt me zbatimin e dispozitave të nenit 474 në lidhje me nenin 337 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për procedurë penale, është hedhur poshtë.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në praktikën e saj gjyqësore lidhur me zbatimin e parimit *Ne bis in idem* ka nxjerrë konkluzion se përgjigja e këtillë e gjykatave vendore nuk është efektive, ngase mund të krijojë përshtypjen e mos ndëshkimit të veprimeve të dhunshme të akuzuari. Mos ngritja e procedurës penale, ose në këtë rast ndërprerja e procedurës veç më të ngritur penale për shkak të shkeljes potenciale të parimit *Ne bis in idem*, nuk është e arsyetuar. Në fakt, sipas paragrafit (2) nga neni 4 Protokollit numër 7 ndaj Konventës lënda mundet që përsëri të shqyrtohet nëse në procedurën e kaluar ka ardhur në “shkelje thelbësore” që do të mund të ndikonin në vendimmarrjen e lëndës.

Në këtë rast, fakti që nuk janë hulumtuar elementet e lëndimit të shkaktuar të rëndë trupor, si dhe se nuk është shqiptuar dënim për të akuzuarin për pasojën e shkaktuar të i dëmtuari është në kundërshtim me parimin *Ne bis in idem* në kuptim të paragrafit (2) nenit 4 Protokollit numër 7 ndaj Konventës.

Duke marrë parasysh të theksuarën, në këtë lëndë, në procedurën përfundimtare të ngritur penale, Paralajmërimi veç më i vendosur për kundërvajtje nuk mund të konsiderohet si rrethanë që e përjashton ndjekjen penale të akuzuarit, për të njëjtën ngjarje. Paralajmërimi i shqiptuar në procedurën për kundërvajtje është sanksioni më i butë, ashtu siç është dashur që procedura penale të vazhdojë, e jo të ndërpritet, për sanksionimin e pasojës së shkaktuar, që nuk është përfshirë me kundërvajtjen, ndërsa është pasojë e veprimeve të kundërligjshme të akuzuarit, që në atë mënyrë do të paraqiste dënim gjithëpërfshirës për veprimet e kundërligjshme të akuzuarit.

Në bazë të së theksuarës, Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e parimit *Ne bis in idem* nga neni 4 Protokollit nr.7 ndaj Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përmes lëndës Kzz.nr.4/2022 ka shprehur qëndrim se kjo është çështje faktike që vlerësohet nga rasti në rast.

Duke marrë parasysh të sipër theksuarën, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konsideron se nuk është e nevojshme të miratohet mendim juridik parimor.

Nga këtu, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u udhëhequr nga e sipër përcaktuara, arriti në konkluzion se nuk janë plotësuar kushtet për miratim të mendimit juridik parimor për çështjen me kuptim të sigurimit të barazisë me zbatimin e ligjeve nga gjykatat, në kuptim të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, në mënyrë që vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut

Seanca e përgjithshme

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 14.07.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), nenit 48 dhe 49 paragrafi (3) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi iniciativën për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga Kryetari i Gjykatës Themelore Koçan, dhe me rastin e Seancës së mbajtur të gjyqtarëve pranë Gjykatës Themelore Koçan, nxori këtë:

KONKLUZION

Iniciativa për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga Kryetari i Gjykatës Themelore Koçan, dhe me rastin e Seancës së mbajtur të gjyqtarëve pranë Gjykatës Themelore Koçan, NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06 ... nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 14.07.2022, diskutoi mbi iniciativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga Kryetari i Gjykatës Themelore Koçan, ndërsa me rastin e Seancës së gjyqtarëve të mbajtur pranë Gjykatës Themelore Koçan.

Në iniciativën e parashtruar janë parashtruar çështjet si në vazhdim:

1.Në procedurën penale për lëshimin e urdhrin penal, nëse në rastin kur me urdhrin penal nuk është dhënë propozim për vendim të shpenzimeve të procedurës, a mundet që gjyqtari individual të marrë aktvendim shtesë për caktimin e shpenzimeve të procedurës pas lëshimit dhe pas plotfuqishmërisë së urdhrin penal.

2.Në rast se ka pengesa objektive për të vepruar sipas LPP, së të gjithë gjyqtarëve që sipas orarit vjetor të punës veprojnë sipas Regjistrit "K", mund t'i jepet në punë një gjyqtari që punon në fushën civile.

Lidhur me çështjen e parë, të parashtruar në iniciativë është theksuar se në Gjykatën Themelore Koçan, ekziston pabarazi të praktikës gjyqësore kur merren vendime për caktimin e shpenzimeve të dëmtuarit në procedurën penale kur shpenzime të tilla janë bërë në procedurën para PTHP Koçan, ndërsa procedura ka përfunduar plotfuqishëm me lëshimin e urdhrin penal ku për shkak se në propozimin për lëshimin e urdhrin penal nuk është dhënë propozimi, ndërsa me aktgjykimin nuk është vendosur për shpenzimet e procedurës penale.

Kjo çështje është shqyrtuar në Seancën e gjyqtarëve pranë Gjykatës Themelore Koçan, më 15.03.2022, megjithatë nuk ekziston përputhshmëri midis gjyqtarëve në mënyrë që një pjesë e gjyqtarëve mbeten në qëndrimin se urdhri penal lëshohet vetëm dhe posaçërisht ashtu siç është propozuar nga Prokuroria Publike dhe në qoftë se në propozimin e dorëzuar për lëshimin e urdhrit penal nuk është propozuar se në cilën mënyrë të merret vendimi për shpenzimet e procedurës, gjykata në aktgjykimin nuk mund të merr vendim të tillë, ndërsa për kërkesën e të dëmtuarit të merret vendim shtesë për shpenzimet e krijuara në procedurën para Prokurorisë Publike nuk mund të përgjigjet pozitivisht, ngase i akuzuari nuk ka parashtruar kundërshtim kundër urdhrit penal ashtu siç është lëshuar dhe do të ishte në dëm të tij shtesë pas skadimit të afatit për kundërshtim të ngarkohet me obligime me vendim të ri, ndërsa këto shpenzime i dëmtuari dhe autorizuesi i tij është duhur t'i lajmërojnë në procedurën para Prokurorisë Publike që ti ketë parasysh gjatë vendimmarrjes së propozimit për lëshimin e urdhrit penal.

Një pjesë e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Koçan, kanë mbetur në qëndrimin se me kërkesën e të dëmtuarit mund të miratohet edhe aktvendim të veçantë dhe shtesë, me të cilin do ti caktohen shpenzimet në procedurën para Prokurorisë Publike, edhe pse në propozimin për urdhrin penal propozim i tillë nuk është dhënë, për shkak që shpenzimet e tilla realisht i dëmtuari i ka, sidomos në pjesën e përfaqësimit të tij nga ana e autorizuesit dhe shpenzimet e këtu duhet ti kompensohen. Kjo sidomos që një numër i madh dukshëm nga kallëzimi penal në PTHP autorizuesit i raportojnë shpenzimet për formulimin e kallëzimit penal, si dhe të procesverbalit për marrjen e deklaratës, kurse ajo që Prokurori Publik në propozimin për lëshimin e urdhrit penal nuk ka dhënë propozim që a të jetë i obliguar i akuzuari me këto shpenzime nuk mund të jetë në dëm të së dëmtuarit dhe këto shpenzime të mos i caktohen.

Sipas nenit 103 nga Ligji për procedurë penale, në çdo aktgjykim dhe aktvendim me të cilin ndërpritet procedura penale, do të vendoset se kush do t'i bart shpenzimet e procedurës dhe sa do të jenë ato.

Kur gjykata të akuzuarin do ta shpall fajtor, në aktgjykimin do të shqiptohet se është i obliguar që t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale.

Çdo procedurë penale, kërkon shpenzime të ndryshme që paraqesin shpenzime të procedurës. Llojet e shpenzimeve dhe mënyra e pagesës së tyre (me vendimin ose shtesën) i përcakton gjykata. Duke qenë se procedura penale udhëhiqet me rastin e një veprë të caktuar penale, është logjike që të gjitha shpenzimet e bëra me atë rast të jenë të kompensuar/të paguara nga kryerësi i veprës penale kur ajo është përcaktuar me aktgjykimin.

Kur i akuzuari është shpallur fajtor gjykata nuk mund të arbitrojë në aspektin e obligimit për kompensim të shpenzimeve, ngase ajo është imperative, që do të thotë obligues.

Gjatë vendimmarrjes për shpenzimet në procedurën penale disa fakte janë gjithmonë me rëndësi të veçantë. Së pari, çështja e fajit; së dyti, mundësia për ndarjen e shpenzimeve lidhur me disa të akuzuar, së treti, faji për shpenzime individuale dhe në fund, ekzistimi apo mosekzistimi me bazë për lirimin nga obligimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës. Të gjitha faktet e theksuara patjetër të jenë të pranishme në mënyrë reale dhe objektive në çdo vendim konkret për shpenzimet në procedurën, dhe në qoftë se nuk janë caktuar atëherë ai vendim nuk do të jetë ligjor. Vetëm parafrazimi i dispozitave ligjore nuk jep në vendimin përmbajtje dhe objektivitet.

Vendimi për shpenzimet e procedurës, merret së bashku me vendimin për çështjen kryesore me rastin që udhëhiqet procedura penale ose vendimi për shpenzimet e procedurës mund të merret në mënyrë shtesë varësisht nga rrethanat e rastit.

Ai që kërkon kompensimin e shpenzimeve duhet të paraqes kërkesë për shpenzimet, për llojin dhe lartësinë e shpenzimeve. Nëse me aktvendimin ose me aktgjykimin nuk është vendosur për shpenzimet (nga çfarëdo lloj arsye), vendimi mund të merret edhe me aktvendim shtesë në bazë të nenit 103 të Ligjit për procedurë penale.

Duke marrë parasysh të theksuarën, lidhur me çështjen e parë të parashtruar nga Kryetari i Gjykatës Themelore Koçan, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të Ligjit për procedurë penale, në procedurën penale për lëshimin e urdhrin penal, në rastin kur me urdhrin penal nuk është dhënë propozim për vendim të shpenzimeve të procedurës, gjyqtari individual që vepron për lëndën mund të miraton aktvendim shtesë për caktimin e shpenzimeve të procedurës pas lëshimit dhe plotfuqishmërisë së urdhrin penal. Kjo për arsye se, shpenzimet që realisht i ka i dëmtuari sidomos në pjesën e përfaqësimit të tij nga autorizuesi i tij, duhet që t'i kompensohen. Ajo që Prokurori Publik, në propozimin për lëshimin e urdhrin penal nuk ka dhënë propozim nëse duhet të obligohet i akuzuari me shpenzimet, nuk mund të jetë në dëm së të dëmtuarit dhe të njëjtat të mos i caktohen.

Lidhur me çështjen e dytë të parashtruar: “Në rast se ka pengesa objektive për të vepruar sipas LPP, së të gjithë gjyqtarëve që sipas orarit vjetor të punës veprojnë sipas Regjistrin “K”, mund t'i jepet në punë një gjyqtari që punon në fushën civile”, e njëjta është në kompetencë të Kryetarit të gjykatës dhe nuk është çështje për të cilën duhet të diskutojë Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duke marrë parasysh të sipër theksuarën, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, konsideron se nuk ka nevojë nga miratimi i mendimit juridik parimor.

Nga këtu, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke u udhëhequr nga e sipër theksuara, arriti në konkluzion se nuk janë plotësuar kushtet për miratimin e mendimit juridik parimor për çështjen me kuptim të sigurimit të barazisë me zbatimin e ligjeve nga gjykatat, në kuptim të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, në mënyrë që vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme